



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS/ SKUPËSTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

| | | | |
|--------|---|--------|-------------------------|
| Për: | Menaxherin e prokurimit AK (MI) | Kopje: | Paneli Shqyrtues - OSHP |
| Prej: | Zeqir Fetoshi - Ekspert shqyrtues i prokurimit | | |
| Lënda: | Ekspertiza lidhur me Arkesat nr. 372/11 e OE „JOOS&KRASNIQI-BAZE-SHPK“-Deçan, Nr. 377/11 e OE „NPNT-ÇLIRIMI“-Prizren, Nr. 378/11 e OE „N.N'R&RUKOLLI-SHPK“-Skenderaj dhe Nr.381/11 e OE„NPT- TONI COM“-Prishtinë. | | |
| Datë | 12.12.2011 | | |

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr.03/L-241 i Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me kërkesat e parashtruara me Nr.372/11 të OE „JOOS&KRASNIQI-BAZE-SHPK“-Deçan, Nr. 377/11 e OE „NPNT-ÇLIRIMI“-Prizren, Nr. 378/11 e OE „N.N'R&RUKOLLI-SHPK“-Skenderaj dhe Nr.381/11 e OE „NPT- TONI COM“-Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës „Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m” me nr. të Prokurimit: MI-11/048/511 të zhvilluar nga AK - Ministria e Infrastrukturës (MI).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit kontraktues - **MI**
- Panelit Shqyrtues - **OSHP**



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS/ SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI MBI EKSPEKTIZËN E EKSPEKTIT SHQYRTUES

| | | | |
|------------------------|-----------------------------|--------------------------------|------------------------------|
| | 01.12.2011 | 01.12.2011 | 12.12.2011 |
| Nënshkrimi i ekspertit | data e autorizimit të eksp. | data e fillimit të ekspertizës | data e dorëzimit të raportit |

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

- 1). Me datën:24.11.2011 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën nr. **372/11** e parashtruar nga OE „**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SHPK**” me seli në Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, me nr. të Prokurimit: **MI-11/048/511** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës-(MI)**.
- 2). Me datën:25.11.2011 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën nr. **377/11** e parashtruar nga OE „**NPNT-ÇLIRIMI**” me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, me nr. të Prokurimit: **MI-11/048/511** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës-(MI)**.
- 3). Me datën:25.11.2011 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën nr. **378/11** e parashtruar nga OE „**N.N'R&RUKOLLI-SHPK**” me seli në Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, me nr. të Prokurimit: **MI-11/048/511** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës-(MI)**.
- 4). Me datën:29.11.2011 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën nr. **381/11** e parashtruar nga OE „**NPT- TONI COM**” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, me nr. të Prokurimit: **MI-11/048/511** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës-(MI)**.

Konform nenit 114 te Ligjit Nr.03/L-241, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS-(MI)**.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues „**JOOS=KRASNIQI-BAZE-SHPK**”, nga Deçani.

Pikat e Ankesës:

- Me datën:22.09.2011 është bërë shpallja e tenderit në faqen elektronike të KRPP-së
- Hapja është bërë me dt:17.10.2011.
- Kriter ka qenë „Çmimi më i ulët”.
- Kemi marr pjesë në procesin e hapjes dhe ecuria e procesit të hapjes ka qenë POZITIVE.
- Jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe jemi njoftuar me shkrim me dt:18.11.2011.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues „**JOOS=KRASNIQI-BAZE-SHPK**” nga Deçani për aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, janë: nenet: 7, 59, 60, të LPP-së.

➤ **DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

- Ne si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë tender publik, konsiderojmë nuk janë të qëndrueshme dhe nuk kanë mbështetje ligjore thënie e AK-së në njoftimin për eliminim se, kinse neve na mungojnë kopjet e kontratave për punë për periudhën tre vjeçare ngase ne si subjekt afarist jemi regjistru me dt:20.05.2010 dhe se gjatë kësaj periudhe kemi kryer punë të ngjashme edhe si kontraktues dhe nënkontraktues po jo në vlerën sa dyfishi i vlerës së ofertës për shkak të kohës së shkurtër të farizmit të subjektit ankues, mirëpo ne posedojmë kuadër teknik dhe eksperiencë, aftësi teknike me makineri dhe plotësim të kushteve në pajtim me nenet: 65, 66, 67, 68, 69 të LPP-së.Prandaj propozojmë që ky tender të rishqyrtohet me vëmendje nga OSHP-ja dhe kontrata ti jepet OE ankues si ofertuesi me çmimin më të ulët.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues „**NPNT-ÇLIRIMI**”, nga Prizreni.

Pikat e Ankesës:

- Më datën:22.09.2011 është bërë shpallja e tenderit në faqen elektronike të KRPP-së
- Hapja është bërë me dt:17.10.2011.
- Kriter ka qenë „Çmimi më i ulët”.
- Nuk kemi marr pjesë në procesin e hapjes.
- Jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe jemi njoftuar me shkrim me dt:11.10.2011.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues „**NPNT-ÇLIRIMI**” nga Prizreni për aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**”, janë: neni: 60 i LPP.

➤ **DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

- Ne si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë tender publik, kemi ofruar çmim më të lirë prej: 485.472.19 euro në krahasim me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, pastaj ne kemi ofruar dëshmi se kemi kryer punë të ngjashme dhe se kemi ofruar garancion për realizimin e tillë.
- AK-së na ka njoftuar lidhur me eliminimin me arsyetimin se na mungon një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtës në projektet e rrugëve, dhe se na mungon edhe një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtës në projektet e rrugëve apo sanimit të urave, ndërsa këto kushte nuk i plotëson as konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës.
- Ak-së nuk e ka konsideruar të papërgjegjshëm kompaninë „Beni-Com”, pasi që ky operator nuk ka psur listën e stafit të kyqur në projekt dhe nuk kanë caktuar as menaxherin e projektit, as menaxherin e punishtes e as personin përgjegjës për punishten, kërkesa këto të specifikuar në dosje të tenderit. Gjithashtu ky OE nuk ka paraqitur raportin e auditimit të vërtetuar nga një auditor i pavarur për vitet:2008, 2009, 2010, ndërsa nuk e ka edhe listën e punëtorëve të vërtetuar në ATK dhe i mungon gjeodeti në listen e stafit dhe nuk e ka formularin që është i lajmëruar në ATK.
- OE „Eskavatori” nuk ka raporte të auditimit të vërtetuar nga një auditor i pavarur për vitet:2008, 2009, 2010, nuk e ka listen e stafit të vërtetuar nga ATK dhe nuk ka gjeodet të lajmëruar në ATK, ndërsa lista e stafit është e njëjta me stafin që është ende në fazën realizimit të projektit ndërtimi i rrugës Shipashnicë-Desivojcë e dhënë nga i njëjti AK-së.
- Konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i ka caktuar bartësit e projektit (menaxherin e punimeve, menaxherin e projektit, udhëheqësin e punishtes dhe udhëheqës të projektit).Prandaj propozojmë që vendimi për dhënie të kontratës të anulohet, të rishqyrtohet vendimi dhe puna të na jepet neve si OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues „N.N'R&RUKOLLI-SHPK”, nga Skenderaj.

Pikat e Ankesës:

- Më datën:22.09.2011 është bërë shpallja e tenderit në faqen elektronike të KRPP-së
- Hapja është bërë me dt:17.10.2011.
- Kriter ka qenë „Çmimi më i ulët”.
- Kemi marr pjesë në procesin e hapjes dhe pas hapjes kemi vërejtur se procesverbali i hapjes nuk ka qenë i nënshkruar nga zyrtari i prokurimit..
- Jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe jemi njoftuar me shkrim me dt:18.11.2011.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues „N.N'R&RUKOLLI-SHPK” nga Skenderaj për aktivitetin e prokurimit „Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m”, janë: nenet: 6, 7, 27, 51, 56, 58, 59 dhe 60 të LPP-së.

- **DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**
- Ne si operator ekonomik kemi marr njoftimin për eliminim në letrën standarde nga ligji i vjetër i prokurimit publik nr.02/L-99 me arsyetimin na mungon një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune dhe se na mungojnë procesverbalet, referencat e pranimit teknik përfundimtar të projekteve, gjë që aspak nuk është korrekte, sepse kompania jone ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, madje dokumente burimore të lëshuara nga vet AK-së-Ministria e Infrastrukturës për kryerjen e kënaqshme të punimeve dhe atë projekte kapitale me vlera të mëdha gjatë tri viteve të fundit.AK-së të gjithë OE të cilët kanë qenë më të lirë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ju ka dhënë arsye të njëjta të eliminimit, ndërsa ne kemi ofruar çmim më të lirë prej 373.346.94 euro më pak se OE i rekonaduar për dhënie të kontratës.
- Kompania jonë deri më tash ka ekzekutuar projekte nga lëmi i infrastrukturës rrugore dhe ndërtimit në përgjithësi në vlerë totale prej:36.995.589.45 euro dhe i kemi të gjitha dëshmitë me shkresa zyrtare dhe referenca që i kemi prezantuar në ofertën tonë.Gjithashtu kemi prezantuar dëshmitë edhe inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv z.Ragip Behrami, pastaj me përgjegjësin më të lartë ligjore dhe profesionale e materiale deklarojmë se këto dokumente së bashku me referencat mbi kryerjen e punimeve dhe kopjet e kontratave ja kemi bashkangjitur dosjes së tenderit që e kemi dorëzuar tek AK-së, mirëpo këto dëshmi nuk janë përfillur nga AK-së, prandaj propozojmë që ky tender të rishqyrtohet me vëmendje nga OSHP-ja dhe të vendoset drejt.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues „NPT- TONI COM”, nga Prishtina.

Pikat e Ankesës:

- Më datën:22.09.2011 është bërë shpallja e tenderit në faqen elektronike të KRPP-së
- Hapja është bërë me dt:17.10.2011.
- Kriter ka qenë „Çmimi më i ulët”.
- Kemi marr pjesë në procesin e hapjes dhe ecuria e procesit të hapjes ka qenë POZITIVE.
- Jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe jemi njoftuar me shkrim me dt:18.11.2011.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues „NPT-TONI COM” nga Prishtina për aktivitetin e prokurimit „

Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m, janë: nenet: 6, 7, 51, 56, 59, 64 të LPP-së.

➤ **DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

- Ne si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë tender publik, kemi qenë me çmim më të lirë prej 880.000.00 euro, në krahasim OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, kështu që jemi diskriminuar kur jemi shpallur të pa përgjegjshëm, pasi që asnjëri nga pretendimet e AK-së për eliminimin tonë nuk janë të vërteta dhe për të vërtetuar këto fakte kërkojmë nga OSHP-ja, që të bëhet hapja e dosjes së tenderit.
- AK-së ka kërkuar disa specifika dhe kërkesa që nuk ka pas nevojë të kërkohen si p.sh. licenca e MTI, pasi që kjo nuk është më obligative për OE që marrin pjesë në ndonjë aktivitet të prokurimit, ku me dt:01.09.2011 është shfuqizuar udhëzimi administrativ 2008/20 mbi dhënien e lejes, ndërsa ne jemi eliminuar edhe me arsyetimin se nuk kemi pasur licencë nga MTI-PN1 dhe PN3, kështu që është bërë favorizim i qart i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, andaj ne propozojmë që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe të respektohen kriteret për dhënie të kontratës.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP (N.42) : 22.09.2011

Lloji i procedurës së aplikuar (N.30-35):-..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.19): Punë/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):17.10.2011/15 ditë

Data e hapjes së ofertave (N.58) -17.10.2011

Data e vlerësimit të ofertave(N.59).....20.10.2011 deri 02.11.2011

Kriteret për vlerësim:

Kërkesat e përshtatshmërisë -Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 03/L-241 Neni 65, siç është e cekur në Pjesën III.1.1), do të dorëzohen në formë të Aneksit.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës – original ose kopje e noterizuar.
3. Një dokument leshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë” Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – original ose kopje e noterizuar dhe jo me e vjetër se 3 muaj para dorëzimit të ofertës.
4. Fatura mbi pagimin e energjisë elektrike të shpenzuar jo më e vjetër se 2 muaj para dorëzimit të ofertës. dhe/ose kontrata e lidhur midis palëve kontraktuese – (KEK) dhe operatori ekonomik, mbi pagimin e energjisë elektrike me këste – për operatorët vendor.
5. Kopje e Licencës nga MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) e noterizuar për këto kode veprimtarie: PN1dhe PN3 {a,b,}.
6. Licenca për transport rrugor të mallrave në Kosovë për nevoja personale (lëshuar nga MI).
7. Plani dinamik sa më i detajuar për kryerjen e punimeve;
8. Propozim/përshkrim i planit të menaxhimit të trafikut gjatë realizimit të punimeve;
9. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.
 - a. Për secilin nënkontraktor që parashihet të angazhohet , kërkohet kopje e licencës së noterizuar për kodet përkatëse sipas punëve për të cilat nënkontraktohet.
 - b. Për ofertuesit jo rezident në Kosovë, kopje e noterizuar e licencës së lëshuar në vendin e regjistrimit të tij, e ekuivalentuar nga MTI dhe përkthyer në gjuhën shqipe, angleze ose serbe. (Ofertuesi jo rezident sipas ligjit aktual të Kosovës – Rregullorja Nr 2004/19 është i detyruar të paraqesë “Çertifikatën mbi regjistrimin e njësisë së përhershme – përfaqësisë në Kosovë” para nënshkrimit të kontratës.
10. Certifikata e TVSH për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara në Kosovë.
11. Në rastin kur tenderuesi është një grup operatorësh ekonomik, një draft kontrate ku është përcaktuar partneri udhëheqës i grupimit, ku është autorizuar partneri udhëheqës të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën dhe ku është përcaktuar ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë brenda grupimit - original
12. Në rastin kur tenderuesi është një grup operatorësh ekonomik, një deklaratë e secilit partner, se pranojnë që të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe veç e veç të obliguar dhe përgjegjës për tenderin e grupit dhe për ekzekutimin e kontratës – prej secilit partner në origjinal (letër me logo, e vulosur dhe e nënshkruar nga drejtuesi ligjor)

Kapaciteti ekonomik dhe financiar -Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Kopjet e kontratave për projektet tuaja të punëve dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve. **jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.**
2. Raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për 3 vitet e fundit të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit.

Kapaciteti teknik dhe profesional

1. **Menaxher i Projektit** të jetë inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë-5 vite përvojë pune pas diplomimit , në lëmin e ndërtimit të rrugëve ; **Të ketë realizuar së paku një projekt sa ½ e vlerës se ofertës**
 2. **Personeli kryesor teknik ;**
 - Një ing. i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv -3 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve .
 - Një ing. i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv -3 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo sanimit të urave dhe strukturave tjera .
 - Një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë - 3 vite përvojë pune pas diplomimit apo inxhinier i gjeodezisë (shkolla e lartë teknike) 5 vite përvojë pune pas diplomimit ;
 3. **Lista e punëtoreve të përhershëm të kompanisë tuaj me të dhënat ne vijim: Emri, moshja e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani. Pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK (Administrata Tatimore e Kosovës).**
 4. Për te punësuarit e ri kërkohet dëshmi nga ATK-ja .(Caktimi i punëdhënësit kryesor) apo
 - a. Kontrata mbi vepër
 5. Një deklaratë mbi fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe numrin mesatar të personelit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit.
 6. Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj siç është e cekur me poshtë:
 - a. **bazë për prodhim të asfaltit të licencuar** me kapacitet minimal prej 80 tone/ore ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik të licencuar i cili ka baze me kapacitetin e lartpërmendur ;
 - b. **Gurëthyes te licencuar** ne pronësi ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik i cili ka gurëthyes të licencuar (me kapacitet jo më të vogël se 30 m3/ore). + Lista e pajisjeve të kërkuar (Referimi në dosjen e tenderit)
 - c. **Bazë për prodhim te betonit** në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik i cili ka bazë me kapacitetin e mjaftueshëm. për përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore.
 7. Punët e nënkontraktuar nuk lejohen të kalojnë vlerën 40 % te ofertës. Ne rast se operatori ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik parasheh që të angazhoj një nënkontraktor me vlerë më të madhe se 10 % te ofertës se tij, atëherë ju duhet ta nominoni atë duke paraqitur emrin e tij dhe licencën e tij.
- Bartësi kryesor i projektit të ketë mbi 60 % te vlerës së projektit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Për Menaxherin e Projektit /Udhëheqës i Punishtes, Personelin Kryesor Teknik të paraqiten CV –te, diplomat përkatëse, kontratat e punës dhe letra reference për punët e mëparshme lëshuar nga punëdhënësit e tyre në lëmin e ndërtimit të rrugëve dhe urave ;
2. Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve te tyre te nevojshme për plotësimin e kërkesave minimale .
3. Për secilin nënkontraktor që parashihet te angazhohet kërkohet të paraqiten informacionet mbi: Emrin, punët që do të kryej, përqindje (%) e vlerës se nënkontraktuar si dhe referencat e tij;

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

| Nr | Operatoret ekonomik | Vendi | Çmimi € | Vërejtje |
|-----|---------------------------------|-----------------------|-----------------|----------|
| 1. | „ARBOTEC&KASTRIOTI” | PRISHTINË | 3.315.700.39 € | JO |
| 2. | „TEKNIKA PROJEKT” | SUHAREKË | 3.483.1946.22 € | JO |
| 3. | „JOOS KRASNIQI” | JUNIK | 2.051.394.64 € | JO |
| 4. | „RSM&TALI” | PRISHTINË/ GJILAN | 3.130.568.48 € | JO |
| 5. | „BENI COM-SHPK&ESKAVATORI-SHPK” | PRISHTINË/ FERIZAJ | 3.152.497.50 € | JO |
| 6. | „JEHONA” | MALISHEVË | 2.857.718.49 € | JO |
| 7. | „NN”R&RUKOLLI-SHPK | SKENDERAJ | 2.779.150.56 € | JO |
| 8. | „MILENIUM&INTEGRAL” | PRISHTINË | 2.940.932.75 € | JO |
| 9. | „BENITA COM&BAGERI” | KLINË | 3.517.856.81 € | JO |
| 10. | „DRINI COMPANY” | PRIZREN | 3.890.745.64 € | JO |
| 11. | „EUROFAMIS” | SUHAREKË | 2.889.175.04 € | JO |

| | | | | |
|-----|--------------------------|-----------|----------------|---------------|
| 12. | „FAMIS CO” | SUHAREKË | 4.259.946.62 € | JO |
| 13. | „KAG ASPHALT” | PRIZREN | 3.437.740.38 € | JO |
| 14. | „BEJTA COM&EUROTRANS” | GJILAN | 3.894.819.13 € | JO |
| 15. | „ASFALTI&ARFA&NDËRTIMI” | PEJË | 3.960.163.76 € | JO |
| 16 | „ALKO IMPEX” | PRISHTINË | 3.171.813.83 € | 1 KOPJE E DOK |
| 17. | „ÇLIRIMI” | PRIZREN | 2.667.025.31 € | JO |
| 18. | „JAHA COM&TRASING GROUP” | PODUJEVË | 3.135.398.11 € | JO |
| 19. | „GEGROUP&ENGINIERING” | PODUJEVË | 4.231.642.78 € | JO |
| 20. | „MEGI BAU&MEGI BAUCH” | PRISHTINË | 2.990.154.66 € | JO |
| 21. | „MIRUSHA TRANSPORT” | KLINË | 3.196.682.73 € | JO |
| 22. | „UNICOM” | SUHAREKË | 2.851.884.23€ | JO |
| 23. | „SHKOZA F07&NDËRTIMI” | PRISHTINË | 3.998.461.18 € | JO |
| 24. | „GRANIT” | ISTOG | 4.345.557.08 € | JO |

| | | | | |
|-----|--------------------------|-----------------|----------------|----|
| 25. | „NNK-TONI” | PRISHTINË | 2.271.673.85 € | JO |
| 26. | „LIKA TRADE&CONEX GROUP” | PRISHTINË/DEÇAN | 3.384.756.83 € | JO |
| 27. | „VICTORIA INVEST” | SUHAREKË | 3.716.759.56 € | JO |

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë të gjithë përfaqësuesit e OE , përveç përfaqësuesve të OE„Beni com&Eskavatori” pastaj „Asfatil&Arfa&Ndërtimi”, „Victoria Invest” dhe „Çlirimi” ku është lexuar emri i operatorëve ekonomik dhe çmimi.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Florije Pajaziti - Kryetare e komisionit
- Abdyl Ymeri - Anëtare e komisionit
- Sami Haziri - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 02.11.2011

Data e njoftimit për dhënien e kontratës:..... 18.11.2011

Raporti i komisionit vlerësues:

Nuk Bazuar në Raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

- 1). **OE „ARBOTEC&KASTRIOTI”** – është i pa përgjegjshëm, i mungon dëshmia se fatura për pagesën e energjisë elektrike nuk është në emër të OE „ARBOTEC dhe OE „KASTRIOTI”, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të Aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për tri vitet e fundit të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit për OE„Arbotec”, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup, mungon një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (të OE „Arbotec” dhe OE„Kastrioti”) janë prezantuar inxhinier i drejtimit hidroteknik).
- 2). **OE „TEKNIKA PROJEKT”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinieri i prezantuar është i diplomuar në vitin 2010).
- 3). **OE „JOOS KRASNIQI”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitet

2008, 2009 të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit .

- 4). **OE „RSM&TALI”**- është i pa përgjegjshëm, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (te OE RSM, inxhinier i prezantuar i drejtimin hidroteknik i cili nuk është në listë të ATK-së, ndërsa te OE „TALI-ING” drejtimi konstruktiv me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, i mungon lista e punëtorëve të përhershëm me të dhënat në vijim:emri, mosha e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani, pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK për OE „TALI”, i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për-bazë për prodhim të asfaltit të licencuar me kapacitet minimal prej 80 ton/ore në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka bazë me kapacitetin e lartë përmendur .
- 5). **OE „BENI COM&ESKAVATORI”**- është i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e parapara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga AK-së.
- 6). **OE „JEHONA”** është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, menaxheri i projektimit i prezantuar i ka dy vite përvojë pune pas diplomimit e jo 5 sic është kërkuar, mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave, i mungon një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë- 3 vite përvojë pune pas diplomimit (ndërsa inxhinieri i i prezantuar ka diplomuar në vitin 2010), mungon fatura mbi pagimin e energjisë elektrike ose kontrata e lidhur ndërmjet palëve kontraktuese..
- 7). **OE „NN”R& RUKOLLI”**- është i pa përgjegjshëm, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinieri prezantuar i drejtimin hidroteknik), i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.
- 8). **OE „MILENIUM&INTEGRAL”**- është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitet 2008, 2009 të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit për OE Milenium, i mungon lista e punëtorëve të përhershëm me të dhënat në vijim:emri, mosha e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani, pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK për OE „Milenium”, i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për-bazë për prodhim të asfaltit të licencuar me kapacitet minimal prej 80 ton/ore në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka bazë me kapacitetin e lartë përmendur, mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (përvoja e inxhinierit të prezantuar 2 vite si dhe në CV dhe referencat e lëshuara mungon përvoja e kërkuar e punës në lëmin e ndërtimit të rrugëve.
- 9). **OE „BENITA COM&BAGERI”**- është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të Aktiviteteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkarisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup, mungon deklarata e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, mungon vërtetimi i ATK-së, mungon kopja e licencës nga MI për OE „Bageri”, mungon një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit(inxhinieri i prezantuar me shkollë të mesme).
- 10). **OE „DRINI COMPANY”**- është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.
- 11). **OE „EUROFAMIS”**- , është i pa përgjegjshëm i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinier i prezantuar i drejtimin hidroteknik), ndërsa në stafin teknik të prezantuar nga OE „Eurofamis” inxhinieri Hekuran Ukaj gjendet njëkohësisht edhe në stafin e prezantuar nga OE„Lika Trade dhe Conex Group” (verifikuar në ATK).
- 12). **OE „FAMIS CO”**- është i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e parapara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga AK-së.
- 13). **OE „KAG ASPHALT”**- është i pa përgjegjshëm, i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për-bazë për prodhim të asfaltit të licencuar me kapacitet minimal prej 80 ton/ore në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka bazë

me kapacitetin e lartë përmendur, mungon periudha e vlefshmërisë së sigurimit të tenderit në afat 120 ditë(OE ka ofruar sigurim për periudhën 90 ditë), i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për gurëthyes të licencuar në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka gurëthyes të licencuar (me kapacitet jo më të vogël se 30m3/ore).

- 14). **OE „BEJTA COM&EUROTRANS”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitet 2009, 2010 të certifikuar nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit për OE „Eurotrans”, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup.
- 15). **OE „ASFALTI&ARFA&NDËRTIMI”** - është i pa përgjegjshëm, i mungon lista e punëtorëve të përhershëm e kompanisë me të dhënat në vijim:emri, mosha e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani, i mungon pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK për OE Ndërtimi, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitet 2008, 2010 të certifikuar nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit për OE „Ndërtimi”, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup .
- 16). **OE „ALKO IMPEX”** - është i pa përgjegjshëm, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinier i prezantuar i diplomuar në vitin 2010), mungon një kopje e dokumentacionit, mungon dëshmia për bazë për prodhimin e betonit në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik i cili ka bazë me kapacitetin e mjaftueshëm..
- 17). **OE „ÇLIRIMI”** - është i pa përgjegjshëm, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve(inxhinieri i prezantuar i diplomuar në vitin 2009 drejtimi hidroteknik), i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (nuk ka prezantuar asnjë inxhinier).
- 18). **OE „JAHA COM&TRASING GROUP”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, mungon certifikata e TVSH-së për OE„Trasing”, mungon fatura për pagimin e energjisë elektrike të shpenzuar dhe /ose kontrata e lidhur midis palëve kontraktuese-(KEK) për OE „Jaha” dhe OE „Trasing”, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave, mungon lista e punëtorëve të përhershëm të kompanisë me të dhënat në vijim:emri, mosha e punëtorit, eksperiencia(vite), pozicioni në kompani, pasqyrat vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK për OE „Jaha” dhe OE „Trasing”.
- 19). **OE „GEGROUP&ENGINEERING”** - është i pa përgjegjshëm mungon kopja e licencës nga MI për OE Engineering, i mungojn referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për-bazë për prodhim të asfaltit të licencuar me kapacitet minimal prej 80 ton/ore në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka bazë me kapacitetin e lartë përmendur.
- 20). **OE „MEGI BAU&MEGI BAUCH”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitet 2008, 2009 të certifikuar nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit për OE „Megi Bauch”, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinier i prezantuar i OE „Megi Bau” i drejtimin hidroteknik kurse inxhinieri i prezantuar i OE „Megi Bauch” pa kontratë pune dhe CV, mungon kopja e licencës nga MI, mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre.
- 21). **OE „MIRUSHA TRANSPORT”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimi përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinier i prezantuar i me dy vite përvojë pune dhe pa diplomë), i mungon një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për vitin 2010 të certifikuar nga një firmë e licencuar

dhe e respektuar e revizionit.

- 22). **OE „UNICOM”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, menaxheri i projektit nuk figuron në listën e ATK, inxhinieri i gjeodezisë nuk është i drejtimit përkatës (mungon përvoja), inxhinieri Lavdim Osmanaj figuron edhe në listën e stafit te kompania „Arbotec” .
- 23). **OE „SHKOZA F07&NDËRTIMI”** - është i pa përgjegjshëm, i mungon një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune(kontrata e punës për punë gjeodezike nuk është e vlefshme, në emër të projektit tjetër), i mungojnë dëshmitë dokumentuese-licenca për-bazë për prodhim të asfaltit të licencuar me kapacitet minimal prej 80 ton/ore në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një OE i cili ka bazë me kapacitetin e lartë përmendur, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.
- 24). **OE „GRANITI”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.
- 25). **OE „TONI”** - është i pa përgjegjshëm, për menaxherin e projektit/personelin teknik-mungojnë:CV, diplomat, kontratat e punës dhe referencat të lëshuara nga punëdhënësi për përvojën e punës në lëmin e ndërtimit të rrugëve, i mungon lista e punëtorëve të përhershëm e kompanisë me të dhënat në vijim:emri, mosha e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani, i mungon pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK, i mungon propozimi/përshkrimi i planit të menaxhimit të trafikut gjatë punimeve, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për tri vitet e fundit të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit, mungon pajtueshmëria e sigurisë së tenderit me kërkesat e dosjes së tenderit, mungon kopja e licencës nga MTI, mungon kopja e licencës nga MI, vërtetimi nga Gjykata Ekonomike e qarkut është kopje dhe ei pa noterizuar, vërtetimi i ATK është kopje e pa noterizuar, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe të aktiviteteve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.
- 26). **OE „LIKA TRADE&CONEX GROUP”** - është i pa përgjegjshëm, i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, mungon një inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (nga OE„Conex” inxhinieri i prezantuar i diplomuar në vitin 2006 nuk është në listë të ATK-së dhe inxhinieri tjetër pa përvojë i diplomuar 2010 drejtimi hidroteknik).Në stafin teknik të prezantuar nga OE „Lika Trade”, inxhinieri Hekuran Ukaj gjendet njëkohësisht edhe në stafin e prezantuar nga OE „Eurofamis”- e verifikuar në ATK.
- 27). **OE „VICTORIA INVEST”** - është i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e parapara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga AK-së.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

| OE | Emri i OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm | Adresa | Çmimi i ofruar |
|----|---|-----------------------|----------------|
| 1. | „BENI COM-SHPK&ESKAVATORI-SHPK” | PRISHTINË/ FERIZAJ | 3.152.497.50 € |
| 2. | „VICTORIA INVEST” | SUHAREKË | 3.716.759.56 € |

| | | | |
|----|------------|----------|----------------|
| 3. | „FAMIS CO” | SUHAREKË | 4.259.946.62 € |
|----|------------|----------|----------------|

- Nga gjithsejtë njëzetë e shtatë (27) operator ekonomik sa kanë marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, tre prej tyre kanë ofruar tender të përgjegjshëm.
- Komisioni i vlerësimit i përbërë prej tre anëtarëve analizuan me hollësi të gjithë dokumentacionin duke iu përmbajtur kritereve të kërkuara ne Dosje te Tenderit, rekomandojnë për dhënie të kontratës OE „BENI COM-SHPK&ESKAVATORI-SHPK”-Prishtinë/Ferizaj, me çmim të ofruar prej: 3.152.497.50 €

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit , është konstatuar, si në vijim:

Konstatimi nr. 1

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit, ka zbatuar procedurë të hapur, me vlerë të madhe, kontratë për punë.

Konstatimi nr. 2

Autoriteti kontraktues, konform nenit: 54 të LPP-së, ka njoftuar me shkrim të gjithë kandidatët dhe tenderuesit e eliminuar dhe të pa suksesshëm, duke ju dhënë sqarimet adekuate për mangësitë që kanë përmbajtur ofertat e tyre dhe karakteristikat me përparësitë përkatëse të tenderit të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Konstatimi nr. 3

Autoriteti kontraktues, ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE të pa përgjegjshëm, pasi që ky operator nuk i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK si në vijim: pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të konsorciumit „Beni com&Eskavatori” nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga një firmë e licencuar e auditimit, pastaj mungon autorizimi apo vendimi për caktimin e menaxherit të projektit lidhur me këtë tender dhe mungojn dëshmitë për përvojën e punës, inxhinieri i gjeodezisë z.Shaqir Kuçi i prezantuar nga OE „Beni Com” nuk figuron në listën punëtorëve të vërtetuar nga ATK-ja dhe nuk ka ndonjë dëshmi që paguhen kontributet për këtë person, ndërsa figuron në listën e stafit udhëheqës të prezantuar dhe të nënshkruar nga OE „Beni Com”, gjithashtu edhe për teknikun e gjeodezisë z.Driton Rysha, OE „Eskavatori” nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se paguhen kontributet në ATK.

Mungon edhe një deklaratë nga konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës, mbi fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe numrin mesatar të personelit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit

Konstatimi nr. 4

Autoriteti kontraktues, ka kërkuar licencën nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (obligative) në kundërshtim me vendimin e MTI të datës:16.09 2011 i cili ka shfuqizuar vendimin Nr.211 të dt: 27.09.2005 për procedurën e licencimit dhe ka shfuqizuar UA Nr.2008/20, për dhënien e lejes, departamenteve, divizioneve në kuadër të institucioneve të Kosovës për kryerjen e punëve nga lëmia e projektimit në sektorin e ndërtimitarisë, ka shfuqizuar UA Nr.10/2010 për licencimin e subjekteve ndërtimore, si dhe UA Nr.02/2011 të dt: 01.04.2011 për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr.10/2010 për licencimin e subjekteve ndërtimore.

Konstatimi nr. 5

Autoriteti kontraktues, ka shpallur të përgjegjshëm OE „Famis Co” i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK-së, me ç’rast pasqyrat financiare dhe bilanci i gjendjes për tri vitet e fundit janë të pa nënshkruara dhe të pa vulosura nga ndonjë firmë e licencuar e auditimit.

Konstatimi nr. 6

Autoriteti kontraktues, ka shpallur të përgjegjshëm OE „Victoria Invest Group” i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK-së, me ç’rast pasqyrat financiare dhe bilanci i gjendjes për vitin 2008 janë të pa nënshkruara dhe të pa vulosura nga ndonjë firmë e licencuar e auditimit, i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktivitetet ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projektevetë punëve dhe/ose aktivitetet ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.

Përgjigje në pikat e ankesës të OE ankues „JOOS&KRASNIQI-BAZE-SHPK” – Deçan.

Lidhur me pretendimet e OE ankues „JOOS&KRASNIQI-BAZE-SHPK”, eksperti shqyrtues konstaton se AK-së nuk i ka respektuar procedurat e prokurimit, edhe pse OE ankues është i pa përgjegjshëm për faktin se i mungojnë kopjet e kontratave për projektet, punët dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktivitetet ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, **jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës**. Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues edhe në ankesë e ka pranuar se ka kryer punë të ngjashme por jo në vlerën sa dyfishi i ofertës.

OE ankues është regjistruar si subjekt afarist me dt:20.05.201, kështu që i mungojnë raportet e auditimit për vitin: 2008 dhe 2009.

Eksperti shqyrtues konstaton se procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform nenit:59 të LPP-së, gjithashtu konstaton se ka shkelje të nenit: 7 lidhur me barazinë në trajtim, jo diskriminimi dhe transparenca, dhe gjithashtu nuk është respektuar neni: 60 i LPP-së - kriteri për dhënie të kontratës, pasi që për dhënie të kontratës është rekomanduar OE i pa përgjegjshëm, prandaj konsideron se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar.

Përgjigje në pikat e ankesës „NPNT-ÇLIRIMI”- Prizren

Lidhur me pretendimet e OE ankues „NPNT-ÇLIRIMI”, eksperti shqyrtues konstaton se AK-së nuk i ka respektuar procedurat e prokurimit, edhe pse OE ankues është i pa përgjegjshëm për faktin se i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve (inxhinieri i prezantuar i diplomuar në vitin 2009 drejtimi hidroteknik), i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (nuk ka prezantuar asnjë inxhinier). Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues i mungojnë pasqyrat financiare dhe bilanci i gjendjes për vitin 2010, të nënshkruara dhe të vulosura nga një firmë e auditimit.

Eksperti shqyrtues konstaton se procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform nenit:59 të LPP-së, gjithashtu konstaton se nuk është respektuar neni: 60 i LPP-së - kriteri për dhënie të kontratës, pasi që për dhënie të kontratës është rekomanduar OE i pa përgjegjshëm, prandaj konsideron se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar.

Përgjigje në pikat e ankesës të OE ankues „N.N'R&RUKOLLI-SHPK” – Skenderaj.

Lidhur me pretendimet e OE ankues „N.N'R&RUKOLLI-SHPK”, eksperti shqyrtues konstaton se AK-së nuk i ka respektuar procedurat e prokurimit, edhe pse OE ankues është i pa përgjegjshëm për faktin se i mungon një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave (inxhinieri prezantuar i drejtimin hidroteknik), i mungojnë referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës, pasqyrat financiare dhe bilanci i gjendjes për vitin 2008 janë të panënshkruara dhe të pa vulosura nga ndonjë auditor apo firmë e revizionit.

Eksperti shqyrtues konstaton se procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform nenit:59 të LPP-së, gjithashtu konstaton se AK-së ka shkelur nenin: 7, 51 dhe 60 të LPP-së, pasi që për dhënie të kontratës është rekomanduar OE i pa përgjegjshëm, prandaj konsideron se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar.

Përgjigje në pikat e ankesës të OE ankues „NPT- TONI COM” – Prishtinë.

Lidhur me pretendimet e OE ankues „NPT- TONI COM”, eksperti shqyrtues konstaton se AK-së nuk i ka respektuar procedurat e prokurimit, edhe pse OE ankues është i pa përgjegjshëm për faktin se: për menaxherin e projektit/personelin teknik-mungojnë:CV, diplomat, kontratat e punës dhe referencat të lëshuara nga punëdhënësi për përvojën e punës në lëmin e ndërtimit të rrugëve, i mungon lista e punëtorëve të përhershëm e kompanisë me të dhënat në vijim:emri, moshë e punëtorit, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani, i mungon pasqyra vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK, i mungon propozimi/përshkrimi i planit të menaxhimit të trafikut gjatë punimeve, i mungojnë raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për tri vitet e fundit të çertifikuara nga një firmë e licencuar dhe e respektuar e revizionit, mungon kopja e licencës nga MI, vërtetimi nga Gjykata Ekonomike e qarkut është kopje dhe e pa vërtetuar, vërtetimi i ATK është kopje e pa vërtetuar, i mungojnë kopjet e referencave/procesverbaleve të pranimit përfundimtar të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore në lëmin e ndërtimit të rrugëve, jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.

Eksperti shqyrtues konstaton se procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform nenit:59 të LPP-së, gjithashtu konstaton se AK-së ka shkelur nenin: 6, 7, 51, 59, pasi që për dhënie të kontratës është rekomanduar OE i pa përgjegjshëm, prandaj konsideron se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues - **Ministria e Infrastrukturës-(MI)**, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509 m**” me nr. të Prokurimit: MI/11/048/511, nuk ka zbatuar procedurat e prokurimit konform LPP-së Nr.03/L-241, prandaj rekomandon panelin shqyrtues që të aprovohen pjesërisht ankesat e OE ankues, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të **anulohet** dhe procedura e lartpërmendur të kthehet në **Ritenderim**, nëse dhe më tutje ka interes për këtë Autoriteti Kontraktues.